

# Fjalori i hedhurinave

## Udhëzues për një ndarje korrekte të hedhurinave urbane

Ky fjalor i hedhurinave është një udhëzues praktik për grumbullimin e diferencuar që synon t'ju ndihmojë që të ndani në mënyrën e duhur hedhurinat tuaja.

Përmban një listë të objekteve dhe materialeve që çdo ditë jemi të detyruar të eliminojmë, për sa u përket **hedhurinave shtëpiake**, të cilat mund

të dërgohen për riciklim nëse dërgohen në **destinacionin e duhur**, për t'u **dhënë një jetë të dytë** objekteve, për të **kufizuar shpërdorimet** dhe për të **zvogëluar ndikimin** ndaj ambientit. Jo vetëm kaq, është pikërisht sasia e hedhurinave të padiferencuara të prodhuara që përcakton tarifën për shërbimin e grumbullimit të hedhurinave që paguhet.

Grumbullimi derë në derë, EkoBus dhe Ekostop, EkoQendra dhe kontejnerë rrugorë të dedikuar janë në dispozicion për t'ju lejuar, në çdo çast, që të çoni në vendin e duhur hedhurinat tuaja!

Secili prej shërbimeve brenda Komunave të zonës që shërbehet nga Alea Ambiente ka oraret dhe karakteristikat e veta:







për të njohur detajet, vizitoni faqen e internetit **www.alea-ambiente.it**,



















**sportelin online**, shkarkoni aplikacionin App Alea Ambiente ose referojuni EkoKalendarit të zonës suaj

## HEDHURINAT TUAJA? ÇOJI NË VENDIN E DUHUR!


















GUIDË PËR LEXIMIN E FJALORIT














### Çdo hedhurine i përkon një ikonë e veçantë











TË LAGËSHTA	
PLASTIKË KANAQE	
LETËR	
TË THATA TË PARICIKLUESHME	
<b>XHAM DERË NË DERË</b> Grumbullimi i xhamit derë në derë është aktiv për të gjithë përdoruesit e Komunave, Forlimpopoli e Bertinoro dhe vetëm për përdoruesit jo shtëpiake që bëjnë kërkesë dhe që gjenden në të gjitha Komunitat ku është parashikuar grumbullimi me kabanat rrugore	
VEGJETALE	























<p align="center"><b>XHAM KËMBANA RRUGORE</b></p> <p>Grumbullimi i xhamit me kambana rrugore është aktiv në Komunitat Castrocaro Terme e Terra del Sole, Civitella di Romagna, Dovadola, Forlì, Galeata, Meldola, Modigliana, Portico e San Benedetto, Predappio, Rocca San Casciano e Tredozio</p>	
<p align="center"><b>EKOQENDËR</b></p> <p>Mos harroni të dërgoni pa pagesë në EkoQendër hedhurinat me dimensione të mëdha, pra që nuk mund të përfshihen në kontejnerin e grumbullimit derë në derë.</p>	
<p align="center"><b>KONTEJNER PËR PILA E BATERI</b></p>	
<p align="center"><b>KONTEJNER PËR ILAÇE TË SKADUARA</b></p>	
<p align="center"><b>EKOBUS</b></p>	
<p align="center"><b>EKOSTOP</b></p>	
<p>Shërbime shtesë për qendrën historike dhe zonat me kompleksitet të veçantë urban në Forlì.</p>	
<p>Për informacione të mëtejshme: <a href="http://www.alea-ambiente.it">www.alea-ambiente.it</a></p>	
<p>Rroba të përdorura (të shqyera, jo më të ripërdorshme)</p>	
<p>Çakmak</p>	
<p>Ngjitëse (letër ngjitëse)</p>	
<p>Ngjitëse (letra e pasme adezive, figurina, etiketa ngjitëse, me origjinë shtëpiake)</p>	
<p>Bllok-kalendar letre</p>	
<p><b>Pema e Vitit të Ri natyrale</b> <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i></p>	
<p><b>Pema e Vitit të Ri sintetike</b></p>	
<p>Ushqime të prishura dhe teprica ushqimesh</p>	
<p>Alumin (vaska të vogla alumini, letër film, etj.)</p>	
<p><b>Amiant</b> <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i></p>	
<p><b>Antiparazitarë (të prodhuar vetëm për përdoruesit shtëpiakë)</b></p>	
<p><b>Varëse palltosh për dysheme ose muri, metali ose plastike</b></p>	
<p><b>Raft i çmontuar</b> <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i></p>	



























Artikuj ndërtimi për mirëmbajtje të vogla (p.sh. tuba)	
Dërrasë për hekurosje <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Absorbentë higjienikë	
Paketa, këllëfë të prishur	
Legen dhe kova plastike të forta	
Paleta (pedana) druri të prishura	
Kuti zami e pastër (p.sh. Vinavil)	
Kuti zami e ndotur (p.sh. Vinavil)	
Kuti me bojë dhe solvente (vetëm prodhime për përdoruesit shtëpiakë)	
Kanaçe dhe kontejner plastike për ushqime	
Kanaçe çeliku, teneqe ose llamarinë e kallajisur bosh dhe e pastër	
Kavanoz qelqi	
Kavanoz plastik bosh për produkte të ndryshme	
Bateria e konsumuar e makinave dhe motoçikletave	
Bateri për celularë	
Shuk (toptha) pambuku	
Rroba shtëpiake (perde, çarçafë, peshqir, kanavacë, etj.) të konsumuara dhe jo më të ripërdorshme	
Gotë letre ose kartoni e pastër	
Gotë letre ose kartoni e ndotur	
Gotë dhe kupë prej materialesh të kompostueshme (celulozë, niseshte misri...)	
Gotë plastike njëpërdorimshme	
Gotë qelqi (jo kristal)	
Biçikletë e prishur <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	

Blister ose kontejnerë në formë plastike (p.sh. lodra, kancelari...)	
Blister për ilaçe	
Bombola alumini pa simbole rreziku (ajkë qumështi, deodorante -parfume, etj.)	
Bombola spray të etiketuara me simbole rreziku (insekticid, llak, etj. të prodhuara vetëm për përdoruesit shtëpiakë)	
Çanta lëkure ose stofi të përdorura jo të ripërdorshme	
Çantë plastike për blerje, e kompostueshme (p.sh. qeset e supermarketit)	
Shishe xhami	
Shishe plastike për ujë, pije freskuese, vaj etj.	
Pulla (kopsa)	
Kuti për lëng frutash, çaj, ajkë qumështi, qumësht (pa pip nëse është plastike)	
Lëvore frutash dhe perimesh	
Qese, borsetë, ambalazh i pastër najloni	
Qese letre	
Qese për çaj (pa filtër)	
Suva të rëna nga prishjet e vogla shtëpiake	
Kalendar letre ose kartoni	
Çorape najloni	
Këpucë të përdorura	
Çorape të përdorura	
Çikërrima (shkopinj ngjitës - zam stick, flamastra - marker, stilolapsa, shirit ngjitës, rigë dhe vizore, skuadra, goma, brumëletre)	
Qiri	
Zorrë uji, për ujitje	






















Pipth plastik njëpërdorimsh	
Flokë dhe qime	
Kapsulë me pluhur kafeje për makina kafeje	
Kapsulë pa pluhur kafeje për makinë kafeje (plastike ose alumini)	
Karikues baterish për celular ose aparate të ngjashme	
Letër thithëse kuzhine e lagur ose me yndyrë	
Letër kopjative	
Letër dylli	
Letër kimike	
Letër furre e përdorur	
Letër për ambalazhime	
Letër fotografike	
Letër për bukën	
Letër e plastifikuar	
Letër sallami e pastër	
Letër alumini dhe vaska të vogla alumini	
Letër smerili	
Dosje transparente plastike	
Karton pice i pastër	
Karton pice me yndyrë dhe/ose me mbeturina ushqimore	
Kartongjeso	
Kartona për pije dhe ushqime të pastra dhe pa pjesë plastike (p.sh. TetraPak)	
Kartona të palosur (sasi të mëdha)	
Kartona të palosur (sasi të vogla)	




















Fishekë të konsumuar për stampante (printer)	
Kuti druri	
Kuti plastike	
Kablo dhe tela elektrike nga punimet e vogla shtëpiake	
CD, DVD, videokaseta VHS dhe këllëfët e tyre plastike	
Celofan dhe film	
Telefona celulare dhe tablet	
Hi oxhaku e thëngjij të fikur	
Qeramikë	
Disqe makinash, biçikletash etj.	
Leukoplast	
Shporta prej vimini	
Mbyllje me letër alumini e kontejnerëve të ushqimit (kos, ëmbëlsira...)	
Rrip i përdorur	
Kompjuter, stampante (printer), faks <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiake (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Kondicionerë <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiake (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Konfeksione kartuçi (p.sh. makaronash, pastë dhëmbësh, drithëra, etj.)	
Enë kuzhine prej plastike të fortë	
Enë të etiketuara me simbole rreziku (vetëm produkt për përdoruesit shtëpiake)	
Kuti/enë plastike për kandila	
Enë qelqi	
Enë për ushqime plastike ose polistiroli (p.sh. vaska, vazo, etj.)	
Kontejner prej alumini për qirinj	
Kontejner prej plastmase për qirinj	





















Kontejner bosh me kolë dhe ngjitës, dezinfektues (të prodhuar vetëm për përdoruesit shtëpiakë)	
Kontejner bosh për shampo, deterzivë	
Kapak metalik	
Batanije e përdorur	
Kopertina fletorësh me unaza	
Kopertona (pa disqe dhe të prodhuar vetëm për përdoruesit shtëpiakë)	
Kupat e akullores prej letre të pastra	
Kupat e akullores prej letre të ndotura	
Kupat plastike të akullores të pastra	
Kupat plastike të akullores të ndotura	
Kozmetikë, kremra, pambuk hidrofil	
Kotonfiok i kompostueshëm	
Kotonfiok me pjesë plastike	
Damixhanë (vetëm qelqi)	
Dekorime për festat e Vitit të Ri (globe, zbukurime të ndryshme)	
Pastë dhëmbësh (tubet bosh)	
Deodorant, parfum për makinë	
Deodorant personal me kontejner plastik ose alumini	
Deodorant personal me kontejner qelqi	
Herbicide dhe dezinfektues (vetëm produkte për pajisje shtëpiake)	
Divan <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Llastik	

Pajisje elektrike shtëpiake me dimensione të mëdha dhe të vogla <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Bar dhe kositje bimësh <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	 
Jashtëqitje të kafshëve të vogla shtëpiake	
Flamastra	
Ilaçe të skaduara	 
Shami letre, kartopoceta të përdorura	
Hekur dhe metale	
Ampula	
Shkrepëse dylli	
Shkrepëse druri	
Tela elektrikë	
Pe për pastrim dhëmbësh	
Filtër ushqimor (kafe, çaj)	
Dritare (pa xhama)	
Lule artificiale plastike ose material tjetër	
Lule të këputura dhe gjethë në sasi të vogël	
Flakon dhe dispenser plastikë për konfeksionimin e produkteve të ndryshme	
Flakone dhe dispenser qelqi për ambalazhimin e produkteve të ndryshme (pjesa plastike futet në vendin për plastikë-kanaçe)	 
Floppy disk	
Fletë letre	
Fletë reklame, broshura	
Gjethë* * <i>Sasi të vogla</i>	
Llum kafeje dhe kapsula të kompostueshme kafeje	









































Gërshërë me pjesë plastike	
Gërshërë metalike	
Furrë <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Fotografi	
Frigorifer <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Frulator (tundës elektrik)	
Kanxhë për mbylljen e thasëve plastike me bërthamë hekuri	
Lodra me përmasa të mëdha	
Lodra me përmasa të vogla prej druri	
Lodra me përmasa të vogla plastike	
Gazeta dhe revista	
Gomë-shkumë	
Çamçakëz	
Varëse rrobash druri	
Varëse rrobash metali ose plastike	
Doreza gome, nitrili ose lateksi	
Lëvozhgat e vezëve, midhjeve, molusqeve, krustaceve	
Ambalazh transparent për karamele, çokollata, bonbone	
Materiale inerte nga mirëmbajtjet e vogla shtëpiake (qeramikë, terrakotë, pllaka, tulla, etj.)	
Kasa, dyer, dritare (pa xhama)	
Brisqe rroje	























Llamba me filament	
Llamba me kursim energjie	
Lesh xhami <i>Shërbimi nuk ofrohet, kontaktoni ndërmarrjet e specializuara.</i>	
Pllaka xhami (jo xhama të dyfishtë ose xhama të blinduar apo me rrjetë të brendshme metalike)	
Teneqe me shirit të salduar kallaji	
Kanaçe alumini për pije	
Pjatararëse <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Rrobalarëse (lavatriçe) <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Dru	
Lente me kontakt	
Shtrojë jo sintetike për kafshë të vogla shtëpiake (edhe e ndotur me jashtëqitje)	
Shtrojë sintetike për kafshë të vogla shtëpiake	
Libra	
Halë peshku	
Kandil alumini	
Kandil plastik	
Pjesë rrënojash e suva (nga punimet e vogla shtëpiake)	
Dyshekë <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Tulla (nga mirëmbajtjet e vogla shtëpiake)	
Garuzhda dhe servise druri	

















Mobilje (druri, vimini, lamina, plastikë...) <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Kapëza druri	
Kapëza plastike	
Monitor dhe televizorë <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Bishta cigareje të fikur krejtësisht	
Kaseta muzikore dhe këllëfët e tyre plastike	
Shirita për lule	
Shirit adeziv	
Negativët e fotografive	
Llambat neoni dhe llamba me shkarkim	
Najlon për ambalazhe	
Syze të prishura	
Objekte qeramike/terrakote të paprishur ose të thyer (vetëm prodhime pajisje shtëpiake)	
Objekte gome	
Vaj për gatim	
Vaj motori (vetëm produkte nga përdoruesit shtëpiakë)	
Ombrella ose çadra të mëdha plazhi të prishura	
Kocka (p.sh. bërçollë, gjel, etj)	
Pambuk rrobaqepësie	
Paketa cigaresh pa pjesë plastike	

Lugëz e vogël akulloreje ose kafeje	
Panolina (pelena) <i>Shërbimi i dedikuar sipas kërkesave për përdoruesit shtëpiakë.</i>	
Mbrojtëse nga dielli për makinë	
Pelush	
Pena dhe flamastra	
Penela, tubeta ngjyrash	
Tiganë metalikë	
Peshq dhe molusqe	
Pesticide (të prodhuar vetëm për pajisje shtëpiake)	
Pllaka (për mirëmbajtje të vogla shtëpiake)	
Pjata, gota dhe takëme njëpërdorimshme prej materialesh të kompostueshme (celulozë, niseshte misri...)	
Pjata dhe enë qeramike të thyera	
Pjata dhe enë plastike njëpërdorimshme (pa mbetje ushqimore)	
Pila të konsumuara	 
Pirofila (pjatanca furre)	
Goma makinash dhe motoçikletash (pa disk, vetëm produkte për përdoruesit shtëpiakë)	
Polistirol (ambalazhe)	
Mbajtëse dokumentesh dhe dosje plastike	
Servise metalike	
Servise (lugë, pirun, thikë) plastike njëpërdorimshme	
Fletore	
Fletore me unaza metalike	
Piktura (korniza)	

Skedarë për dosje kartoni pa pjesë metalike	
Radiografi	
Degë, krasitje pemësh dhe gardhe pemësh <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës</i>	 
Makina rroje plastike njëpërdorimshme	
Rripa për pako	
Mbetje bimësh të kopshtit dhe bimësh zbukuruese	 
Mbetje frutash, perimesh dhe ushqimesh	
Rrjeta shtretërisht <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Rrjeta plastike për fruta e perime	
Revista	
Rrotulla dhe mbajtëset qendrore të letrës (p.sh. letër higjienike, letër kuzhine, etj.)	
Qese për dializa dhe të stomatizuar* * <i>Mundësia për të kërkuar një kontejner të dedikuar me programin familje eko-e-qëndrueshme.</i>	
Qese letre	
Qese ose ambalazhe të tjera në disa materiale jo të ndashme	
Qese, çantë ose veshje plastike të pastra	
Qese, çantë ose veshje plastike të ndotura	
Qese ose kuti plastike për paketimin e rrobave	
Qese për fshesë elektrike	
Kartopçeta	
Pajisje sanitare pa rubinetat (nga mirëmbajtje të vogla shtëpiake)	
Këpucë të prishura, jo të ripërdorshme	

Këpucë me qafa për ski të prishura	
Kuti metalike (për biskota, çokollata, aksesorë, etj.)	
Ski	
Kuponë pagese prej letre kimike	
Kovë plastike	
Karrige, shezlong, karrige për fëmijë <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Tallash (sasi të vogla)	
Kositje bari	 
Shiringë (e mbyllur me tapë)	
Sende zbukuroese dhe objekte plastike shtëpiake	
Furçë, krehër ose fshesë	
Brushë dhëmbësh	
Fragmente pasqyre	
Pasqyrë komplete	
Sfungjer	
Sfungjer sintetik për lule	
Bisht/lugë druri për akullore	
Fitil për qirinj	
Enë plastike njëpërdorimshme (me përjashtim të serviseve plastike njëpërdorimshme)	
Lecka	
Struktura hekuri	
Kruese dhëmbësh	

Dërrasë mishi	
Dërrasë mishi plastmase	
Tampona për vula	
Bidon bosh për përdorim shtëpiak, prej teneqeje ose plastike, të pastër	
Tapë natyrale	
Tapë metalike	
Tas ose filxhan qeramike i thyer	
Telefon (fiks ose portativ) <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Televizor ose ekran <i>Grumbullim në banesë sipas kërkesës për përdoruesit shtëpiakë (Konsultoni faqen e internetit).</i>	
Fshirëse xhamash makine të prishura	
Termokonvektorë dhe radiatorë	
Termometër mercuri (vetëm produkte nga përdoruesit shtëpiakë)	
Termometër digjital	
Tokë dhe kompostim për vazo (në sasi të vogla)	
Terrakotë	
Teserë ose kartë e plastifikuar	
Tetrapak	
Toner <i>Shërbim i dedikuar për ndërmarrjet sipas kërkesës.</i>	
Peceta letre (kartopeceta) të pastra	
Peceta letre të ndotura	
Pllaka zdrukthi (sasi të vogla)	
Zdrukth i mprehjes së lapsit ose pastele	

Tubete metalikë bosh (p.sh. për majoneze, bojë këpucësh, etj.)	
Tuba gome (p.sh. zorrë për të ujitur kopshtin, duke përjashtuar plastikën bujqësore)	
Tyl	
Pajisje plastike të ndryshme kuzhine (tasa, dërrasa mishi, enë)	
Valixhe, çantë shpine, çantë udhëtimi	
Vaskë, tabaka alumini për ushqime, plastike ose polistiroli për ushqime	
Vaskë kartoni për mbajtjen e vezëve	
Kavanoz plastik për kos	
Vazo dhe nënvazo plastike për lule të pastra dhe me prejardhje shtëpiake	
Vazo plastike për bimë	
Tabaka dhe konfeksione kartoni	
Xham	
Fibër xhami <i>Shërbimi nuk ofrohet, drejtohuni te ndërmarrjet e specializuara.</i>	
Videokaseta dhe këllëfët e tyre plastike	
Videolojëra elektronike	
Rrjetë kundër mushkonjave, copa të vogla rrjete	
Fshirëse këmbësh	
<b>SHËRBIMET PLOTËSUESE</b>	



## **KOMPOSTIMI SHTËPIAK**

Nëse ju si përdorues keni një kopsht perimesh ose një lulishte, ju mund të bëni kompostimin shtëpiak, duke i transformuar kështu hedhurinat e lagështa (mbeturinat ushqimore dhe kositjet e vogla të barit)

në humus të shkëlqyer për të plehëruar tokën. Ju mund ta bëni këtë duke përdorur një kompostues (kontejner i veçantë, që jepet në përdorim falas nga Alea Ambiente) ose me sisteme të tjera, të tilla si një kuti kompostimi ose një gropë kompostimi për plehërim.

Prodhimi i kompostimit shtëpiak ndihmon në reduktimin e hedhurinave të grumbulluara, duke pasur përfitime për ambientin dhe për të gjithë komunitetin dhe ju lejon, në rast se hiqni dorë zyrtarisht nga shërbimi i grumbullimit derë në derë duke e kthyer kontejnerin e duhur, që të përfiton nga një ulje e kostos së faturës për shërbimin e grumbullimit të hedhurinave (sipas Rregullores tarifore në fuqi, për një shumë të barabartë me 30% të kuotës së ndryshueshme të tarifës).

## **ILAÇE TË SKADUARA & PROJEKTI I ILAÇIT SOLIDAR**

Barnat e skaduara duhet të hidhen në kontejnerët e posaçëm që ndodhen pranë farmacive komunale dhe private të territorit. Në mënyrë tipike, nëse ilaçi nuk është "i hapur", hidhet pa ambalazhin e jashtëm, pasi kutia ose shishja duhet të ndahen në kontejnerët përkatës të grumbullimit derë në derë. Pranohen të gjitha llojet e ilaçeve, me përjashtim të atyre citotoksike.

Në disa komuna në zonën Forli, është gjithashtu aktiv projekti i Ilaçit Solidar (Farmaco Solidale) në bashkëpunim me Komitetin për Luftën kundër urisë në botë (organizatë jofitimprurëse e shërbimeve sociale), Federfarma Forli, Forlifarma, Dhoma e farmacistëve dhe e mjekëve kirurgë dhe odontoiatër në Forli-Cesena, AUSL Romagna dhe Caritas: barnat në konfeksione të pahapura dhe të paskaduara mund të depozitohen nga

qytetarët në kontejnerët e posaçëm të vënë në dispozicion nga Alea Ambiente brenda farmacive që marrin pjesë në projekt. Këto, pikërisht sepse janë në gjendje të përsosur konservimi, do të destinohen për grupet më të dobëta, që kanë nevojë për terapi farmakologjike.

Përfshihen në këtë lloj iniciative ilaçet si antibiotikët, vitaminat, mukolitikët, dermatologjikët (kremra) dhe të tjerë, me përjashtim të atyre për të cilat kërkohen masa paraprake të veçanta për ruajtjen e tyre, si zinxhiri i të ftohtit (për mallrat e tejngrirë), lëndët narkotike dhe ato të përdorimit ekskluziv në spital.

## **VAJRAT E KONSUMUAR**

Vajrat e kuzhinës (për conserva, gatime, skuqje ose për rregullimin e ushqimeve) duhet të vendosen në kontejnerët përkatës rrugor (për vendndodhjen e saktë shihni faqen e internetit ose kërkoni informacion tek asistencja e rrjetit të klientit) ose ata që janë të pranishëm në EkoQendrat Forli, Bertinoro (lokaliteti Santa Maria Nuova), Galeata, Predappio, Castrocaro Terme e Terra del Sole, Rocca San Casciano e Modigliana.

Në rastin e vajit dhe grasos minerale (për makina, motoçikleta, etj.), bateritë (për makina, motoçikleta...)

ose qarqe hidraulike, është e nevojshme të drejtoheni te EkoQendrat në Forli, Bertinoro (Santa Maria Nuova), Galeata e Modigliana.

Në të dyja rastet, eliminimi bëhet falas.

## **PILAT E KONSOMUARA**

Pilat për përdorim shtëpiak (bateritë dhe akumulatorët, kategoria PA), përmbajnë metale të rënda të tilla si merkuri, kadmiumi, plumbi dhe kromi dhe, pasi të jenë konsumuar, ato duhet të depozitohen në kontejnerë të posaçëm rrugorë pranë supermarketeve, cigareshitësve dhe të pikave të shitjes të shpërndarjes elektronike me shumicë.

Nëse braktisen ose eliminohen në atë të padiferencuarën, ato mund të kontribuojnë në ndotjen e ujërave me efekte toksike ndaj shëndetit të njerëzve dhe kafshëve.

Përndryshe, ato mund të sillen në një EkoQendër dhe të depozitohen në kontejnerin përkatës, pa asnjë detyrim.

## **TEKSTILET**

Për detajet mbi grumbullimin e veshjeve të përdorura, konsultoni faqen e internetit [www.alea-ambiente.it](http://www.alea-ambiente.it) ose aplikacionin Alea Ambiente për të qenë të informuar për të rejat e shërbimit.

## **HEDHURINA HIGJENIKE-SANITARE**

Hedhurinat higjienike-sanitare të prodhuara zakonisht në kushte familjare janë zakonisht të destinuara për eliminim në kontejnerin e lëndëve të thata.

Megjithatë, në kushte të veçanta

nevojash, është e mundur të hyni në projektin Familja Eko-e qëndrueshme, që i drejtohet bërthamave familjare në të cilat ka foshnja, të moshuar, invalidë, pacientë me dializë ose të stomatizuar, me inkontinencë, me vendbanim të regjistruar tek përdoruesi, aty ku kërkohet shërbimi.

Për ata është në dispozicion një kontejner i veçantë për panolina dhe panolona (pelena) i cili zbrazet rregullisht sipas orarit të grumbullimit derë në derë (hedhurinë e thatë), kundrejt një tarife "solidariteti" (d.m.th. të reduktuar) që në disa Komuna nuk parashikon asnjë kosto në ngarkim të përdoruesit, pasi ajo përballohet krejtësisht nga Administrata.

Regjistrimi për këtë shërbim duhet t'i komunikohet zyrtarisht Alea Ambiente duke tërhequr kontejnerin e posaçëm të dedikuar dhe, në rastin e fëmijëve, ai parashikohet deri në muajin e 30-të të fëmijës. Duhet mbajtur mend gjithashtu se brenda EkoQendrave fikse të territorit ka kontejnerë të dedikuar për grumbullimin falas të kësaj lloji hedhurine.

## **HEDHURINAT VOLUMINOZE**

Hedhurinat që për shkak të dimensioneve dhe/ose peshës së tyre nuk mund të vendosen në kontejnerët për grumbullimin derë në derë mund të dërgohen në mënyrë autonome në një EkoQendër pa pagesë ose mund të tërhiqen lehtësisht në shtëpi nga operatorët e Alea Ambiente.

Tërheqja në shtëpi është një shërbim me pagesë (për të njohur kostot, kontrolloni te

faqja e internetit ose drejtoheni te rrjeti i klientëve Alea Ambiente) i cili mund të përfshijë deri në një maksimum prej 6 copë njëherësh, sipas llojeve të mëposhtme:

- Bicikleta
- Pajisjet shtëpiake të mëdha (RAEE):  
tharëse rrobash, fshesa me korrent, boiler, kaldaja, kondicionerë, ngrirës, furnela, soba, furra elektrike ose me mikrovalë, frigoriferë, pjatararëse, rrobalarëse (lavatriçe), monitor për PC, stufa, televizorë ose radiatorë elektrikë,
- Kasa, dyer, dritare (jo nga demolimet) si p.sh. kangjella, dritare pa xhama, grila, porta, parmakë, role ose grila/  
grila me rul,
- Mobilie (edhe mobilitet e kopshtit): dollapë, divane, shtretër, dyshekë, sergjene, mobilie kuzhine, kolltukë, rrjeta krevatesh, rafte, karrige, tapeta ose tavolina.

Materialet duhet të ekspozohen mbi tokën publike ose brenda pronës private, pranë gardhit (në një pikë që mund të arrihet pa pengesa (si p.sh. makina të parkuara, pemë, shtylla etj. nga automjeti që përdor vinçin), një natë përpara ditës së grumbullimit. Ju lutemi vini re se për sistemet sanitare dhe termosanitare nuk parashikohet tërheqja në shtëpi pasi këto janë materiale inerte që duhet të dorëzohen pranë EkoQendrave.

## **HEDHURINA XHAMI**

Në Komunat ku grumbullimi i xhamit nuk kryhet me metodën derë në derë, janë të pranishme kambanat përkatëse rrugore të shënuara, të cilat shërbejnë për

grumbullimin e objekteve ekskluzivisht prej qelqi (jo kristali apo pireks, as pasqyra apo enë porcelani). Shishet dhe kavanozat e qelqit gjithashtu mund të hidhen me tapë ose kapak dhe fillimisht duhet të zbrazen plotësisht nga lëngu që kanë brenda, pa qenë e nevojshme të lahen.

## **KOSITJET E KRASITJET**

Bari, gjethet, degëzat, trungjet me përmasa të vogla mund të treten pa pagesë tek EkoQendrat, ose ato mund të tërhiqen në banesë nga Alea Ambiente nëpërmjet shërbimit përkatës me pagesë. Për të njohur kostot, mund të kontrolloni faqen e internetit në seksionin përkatës ose mund të drejtoheni te rrjeti i klientëve.

## EKOQENDRAT

Qendrat e grumbullimit janë vende të destinuara për të pranuar hedhurinat e diferencuara që dërgohen në mënyrë të pavarur nga qytetarët për eliminimin e tyre falas. Në territor janë të pranishme Ekoqendrat fikse, vende të kontrolluara dhe të mbyllura që kryejnë shërbimin, të hapura në ditë dhe orare të caktuara dhe EkoQendrat e lëvizshme (konsultoni EkoKalendarin).

Çdo EkoQendër fikse ka një kalendar dhe orarin e vet të aktiviteteve, sipas të cilit pranohen, titullarët e shërbimeve shtëpiake ose jo shtëpiake, në mënyrë që të plotësohen nevojat specifike të secilit. Ka mundësi të shkoni në secilën nga EkoQendrat fikse ose të lëvizshme që ekzistojnë në territor, pavarësisht

nga komuna juaj e banimit, vetëm duke sjellë me vete një faturë Alea Ambiente me emrin e konsumatorit të shërbimit. Konsultohuni me listën e materialeve që mund të dorëzohen në çdo EkoQendër, duke vizituar faqen e dedikuar të internetit [www.alea-ambiente.it](http://www.alea-ambiente.it), ose duke shkarkuar aplikacionin App Alea Ambiente.

## REGULLAT PËR PËRDORIMIN E EKOQENDRAVE JANË TË PAKTA DHE TË THJESHTA:

- Duhet respektuar sasi të maksimale dhe të lejueshme dhe lloji I materialeve të pranuar (info në faqen e internetit Alea Ambiente ose nga shërbimi i asistencës në rrjet i klientëve)
- Çoni hedhurinat të ndara paraprakisht sipas llojit dhe duke e zvogëluar vëllimin e tyre
- Ndiqni Udhëzimet e tabelave dhe të personelit të strukturës
- Mos merrni hedhurina që gjenden Brenda qendrës
- Mos lini materiale jashtë EkoQendrës

Përveç kësaj, në EkoQendrat fikse në Bertinoro, Castrocaro Terme, Forlì, Forlimpopoli, Galeata, Modigliana, Predappio, Rocca San Casciano e Tredozio ka mundësi të hidhen

edhe **hedhurinat higjienike-sanitare** si panolona dhe pelena (panolina).

Për të përdorur shërbimet e EkoQendrës së Lëvizshme, një mjet udhëtues që mund të mbledhë vetëm disa lloje hedhurinash, është e mundur të shkoni në çdo pikë ku qëndron automjeti, sipas asaj që tregohet në EkoKalendarin e zonës suaj.

EkoQendra e lëvizshme është e pranishme në Komunat ku nuk ekziston një EkoQendër fikse, ose kur kjo nuk është e pajisur për të mbledhur të gjitha llojet e hedhurinave.

## KËTO JANË TIPOLOGJITË E HEDHURINAVE TË GRUMBULLUARA:

- Bateri
- Bombola spray
- Karton
- Kontejnerë plastikë
- Kozmetikë
- Pajisje elektroshtëpiake (të vogla e të mëdha)
- Ilaçe
- Hekur
- Filtra vaji
- Frigoriferë
- Inerte
- Objekte të mëdha (kaba)
- Llamba
- Dru
- Vaj mineral
- Vaj vegjetal
- Pila dhe akumulatorë
- Plastikë
- Goma makinash
- Produkte të ndezshme
- Televizorë
- Vegjetal
- Vernikë

## SI TË NXJERRIM JASHTË KONTEJNERËT DERË NË DERË

### **Ku?**

Në tokë publike, afër vendit të shërbimit tuaj, ku zhvillohet kalimi i mjeteve për grumbullimin.

### **Si?**

Mundësisht plot, me kapak të mbyllur dhe pa thasë përjashta. Nëse kontejneri nuk është plot, prisni grumbullimin e ardhshëm!

### **Kur?**

**Mbrëmjen përpara ditës së grumbullimit të shënuar në Ekokalendar, nga ora 21.30 deri në orën 4.30 në ditën e grumbullimit, përveçse në zonën Forlì Centro Storico, ku kontejneri duhet të vendoset në të njëjtën mbrëmje të ditës së shënuar në Ekokalendar**

**KUJDES!** Në rast moti me dëborë, boshatisja e kontejnerit do të bëhet menjëherë sapo kushtet e ambientit do të lejojnë grumbullimin e sigurt në përputhje me kalendarin.

### **Pas boshatisjes**

- kontejneri lihet me kapakun e hapur për të sinjalizuar që grumbullimi është kryer
- kontejneri duhet të tërhiqet dhe të dërgohet në tokë private sa më shpejt që të jetë e mundur, për të zvogëluar pengimin e qarkullimit dhe për të përmirësuar dekorin urban

Sinjalizoni çdo problem të mundshëm ose nevoja të veçanta: Alea Ambiente është në dispozicion për të përcaktuar

zgjidhje specifike që mundësojnë përmirësimin e shërbimit të ofruar.

## ADEZIVI I SINJALIZIMIT

Për të sinjalizuar gabimet eventuale dhe për të përmirësuar cilësinë e materialeve në mënyrë që ato të dërgohen për rikuperim, punonjësit u aplikojnë kontejnerë adezivë të veçantë për t'ju njoftuar kur keni kryer gabime në shpërndarjen e hedhurinave (p.sh. nëse përdoren qese ose thasë të papërshtatshëm ose futen hedhurinat në kontejnerin e gabuar). Ky sistem është futur për të ndihmuar qytetarët që të ndajnë hedhurinat në mënyrë korrekte, dhe ka një vlerë thjesht informative dhe jo sanksionuese.

## PËRDORUESIT JO SHTËPIAKË

Me përdorues jo shtëpiakë nënkuptojmë hapësirat e destinuara për prodhim dhe/ose shitje mallrash ose për shërbime dhe të gjithë ato lokale që nuk përdoren për qëllim banimi. Për ta funksionon grumbullimi i diferencuar me sistemin derë në derë të fraksioneve të plastikës, letrës, të materialeve të lagështa e të thata, të pa riciklueshme dhe, në Komunitat ku është parashikuar (aktualisht Bertinoro dhe Forlimpopoli), edhe të xhamit. Përdoruesit jo shtëpiakë mund të pajisen me kontejnerët që janë më të përshtatshëm sipas nevojave të tyre, duke filluar me pajisjet standarde.

## SHËRBIME STANDARD

Këto shërbime parashikojnë furnizimin me kontejnerë që kanë një dimension (30 ose 120 lt) dhe frekuencën e zbrazjes së fraksioneve të veçanta sipas modaliteteve dhe orareve të paraqitura në EkoKalendar, pikërisht ashtu si për përdoruesit shtëpiakë.

## SHËRBIME EKSTRA-STANDARD (ose ME PESHË)

Kontejnerët në dispozicion janë nga 240 lt, 360 lt, 1700 lt ose nga 12 deri në 25 m<sup>3</sup>. Për hedhurinat e lagështa, qelq dhe bimore, mund të zgjidhen vetëm këto vëllime, nga 120 ose 240 lt. Për kontejnerët nga 1700 lt e lart, zbrazja duhet rezervuar domosdo me telefon, e-mail ose direkt nga sporteli online, dhe garantohet brenda 48 orëve pasuese (duke përjashtuar të shtunat dhe të dielat).

Rezervimi i zbrazjes së kontejnerëve nga 1700 lt ose nga 12 apo 25 m<sup>3</sup>, nga ana e ndërmarrjes duhet të rezervohet duke plotësuar formularin përkatës në faqen e internetit dhe duke e dërguar në:

**impresa@alea-ambiente.it** ose duke hyrë në sportelin online nga faqja e internetit **www.alea-ambiente.it**

Për të pasur një shërbim të garantuar e të përpiktë të zbrazjes, brenda 48 orëve (përjashtohen të dielat dhe festat), duhet që komunikimi të dërgohet nga e hëna deri në të enjten: brenda orës 13:00, të premten: brenda orës 11:30.

Kërkesat e marra jashtë orareve të caktuara mund të jenë subjekt i vonësive në lidhje me ekzekutimin e tyre.

## SHËRBIME TË TJERA

## **SPORTELI ONLINE**

### **I THJESHTË**

pamje ekrani unike  
më të gjitha të dhënat tuaja

### **PRAKTIK**

udhëzime dhe këshilla  
të nevojshme për administrimin e hedhurinave

### **I SHPEJTË**

info-t e tua  
gjithnjë të azhuruara

### **Regjistrohuni në sportelin online nëpërmjet faqes së internetit Alea**

#### **Ambiente dhe në çdo çast keni mundësi**

- të kontaktoni menjëherë Alea Ambiente dhe të kërkonte informacione
- të njihni detajet e përdoruesit (n. matrikulli dhe llojin i kontejnerit derë në derë)
- të monitoroni shërbimet aktive, edhe ato me pagesë
- të shihni n. dhe datën e zbrazjeve të kontejnerit të hedhurinave të padiferencura
- të gjeni dhe të shkarkoni të gjitha faturat tuaja në format elektronik
- të paguani online faturat tuaja, nëpërmjet portalit PagoPA
- të konsultoheni me kalendarin e grumbullimit derë në derë në zonën tuaj
- të kontrolloni në fjalorin e hedhurinave ku do të hidhen objektet
- të dërgoni sinjalizime për mirëmbajtjen e koshave buzë rrugës, braktisjen e hedhurinave

## **APP**

### **Me aplikacionin App gratis të Alea Ambiente nëpërmjet smartphone dhe tablet keni mundësi**

- të konsultoheni me EkoKalendarin me programin ditor të grumbullimit derë në derë në zonën tuaj të referimit
- të merrni njoftime për ndryshimet e orareve dhe komunikimet urgjente në lidhje me shërbimin e higjienës urbane dhe administrimin e hedhurinave në Komunën tuaj
- të sinjalizoni drejtpërdrejt në repartin operativ rastet e mungesës së grumbullimit derë në derë, hedhurinave të braktisura në rrugë dhe koshat e rrugës të mbushur plot
- të kontrolloni se si t'i hidhni siç duhet hedhurinat tuaja
- të konsultohuni me oraret dhe rregulloret e EkoQendrave dhe të Pikave Alea

## **EDUKIMI AMBIENTAL**

Alea Ambiente është e pranishme në gjitha llojet e nivelet e shkollave në territor me një projekt Edukimi Ambiental që propozon një udhëtim ndërgjegjësues mbi çështjet aktuale ambientale, zhvillimin e qëndrueshëm, konsumin e ndërgjegjshëm, hedhurinat si burim ekonomik, grumbullimin e diferencuar si mjet efikas, ekonominë qarkore si një vizion për të ardhmen. Projekti, gjithashtu synon të inkurajojë dhe t'u japë mundësi nxënësve të shprehin mendimin e tyre (në bazë të grupmoshave) mbi kuptimin e gjurmës ekologjike dhe mbi përgjegjësinë e përbashkët ndaj ambientit ku ata jetojnë.

Nëpërmjet mësimdhënies ludike-laboratorike ose instrumenteve të mësimdhënies në distancë, fëmijët mund të përballen me njëri-tjetrin, të zbulojnë mënyra të reja të të mësuarit dhe të krijojnë një ide mbi temat e trajtuara. Më në fund, itinerari përfundon me realizimin e një punimi krijues që përshkruan konceptet e mësuara ose duke sajuar një slogan për të shpjeguar se çfarë nënkuptojnë konceptet e "përgjegjësisë së përbashkët" dhe të "të mirës së përbashkët".

ALEA Ambiente

Via Golfarelli, 123 - Forlì

[www.alea-ambiente.it](http://www.alea-ambiente.it)

Call center: (centrali) nga e hëna deri të premten

8:30-18:00 dhe të shtunën 8:30-13:00

(duke përjashtuar ditët e festave)

Tel. 0543.784700 (nga tel. celular)

N. Jeshil 800.68.98.98 (nga tel fiks)

aleambienterifiuti

App Alea Ambienti

Sporteli online